

Buletini Ekonomik Janar - Dhjetor i Vitit 2025

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

Mars, 2026

Përmbajtja

Hyrje	3
Rreth Nesh	3
Pasqyra e Ekonomisë së Kosovës	4
Inflacioni mujor dhe vjetor	7
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	7
Ndryshimet e çmimeve për grupet dhe nëngrupet	9
Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) të Kosovës	10
Tregtia e jashtme e mallrave eksporti-importi, janar - dhjetor 2025	10
Eksportet e mallrave	14
Eksportet me vendet e BE-së	14
Eksportet me vendet e CEFTA	15
Eksportet me vendet e BE-së , CEFTA dhe vendet tjera të botës	16
Importet e mallrave	19
Importet nga vendet e BE-së	19
Importet nga vendet e CEFTA	20
Importet nga vendet e BE-së , CEFTA dhe vendet tjera të botës	21
Bilanci i Pagesave të Kosovës	23
Investimet e Huaja Direkte (neto) në Kosovë	24
Investimet Direkte të Kosovë (jashtë vendit)	27
Dërgesat e migrantëve- Remitancat për në Kosovë	28
Të Hyrat dhe Shpenzimet buxhetore,	30
Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara	33
Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve sipas aktivitetit deri dhjetor 2025	36

Hyrje

Ky dokument (Buletini Ekonomik) ofron një pasqyrë të detajuar të ekonomisë së Kosovës, duke përfshirë të dhëna për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2025.

Raporti ofronë të dhëna mbi **rritjen e Bruto Prodhimit Vendor prej 3.6%**, qe parqet një ritëm i moderuar i rritjes ekonomike me sinjale të lehta të ngadalësimit. Një fokus i veçantë u kushtohet **Statistikave të tregtisë së jashtme**, ku evidentohet thellimi i deficitit tregtar për shkak të rritjes së lartë të importeve kundrejt eksporteve të kufizuara.

Raporti shqyrton gjithashtu trendet e **Inflacionit**, i cili arriti një mesatare vjetore **prej 3.9%**, si dhe lëvizjet e çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore.

Për më tepër, raporti pasqyron ecurinë te **Bilancit i Pagesve të Kosovës**, të **Hyrat dhe Shpenzimet** buxhetore, lëvizjet te **Investimeve të Huaja Direkte (IHD)**, të **Remitancave** (Dërgesave të migrantëve), ku Gjermania dhe Zvicra mbeten partnerët kryesorë. Së fundi, ofrohen statistika mbi **numrin e ndërmarrjeve** të regjistruara, numrin dhe strukturën e bizneseve aktive sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik.

Raporti, është përgatitur nga Oda Ekonomike e Kosovës, bazuar në të dhënat e Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK), Doganat e Kosovë (DK), Administrat Tatimore e Kosovë (ATK) dhe Banka Qendrore e Kosovë (BQK).

Rreth Nesh

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizatë profesionale, e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Si organizatë e pavarur, jopolitike dhe jofitimprurëse, përfaqëson në mënyrë legjitime interesat e komunitetit të biznesit në vend.

OEK-u shërben si një burim i besueshëm informacioni për ndërmarrjet vendore dhe si një pikë lidhëse me partnerët ndërkombëtarë.

OEK-u angazhohet në mënyrë aktive në analizimin e gjendjes ekonomike në Kosovë dhe në hartimin e propozimeve për zhvillimin e modeleve të reja dhe të avancuara të biznesit. Përmes përpjekjeve të saj për ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve kosovare,

OEK-u kontribuon në fuqizimin e kapaciteteve konkurruese të sektorit privat. Me praninë e saj në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës siguron një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe një qasje të strukturuar në përkrahje të zhvillimit ekonomik të vendit.


Pasqyra e Ekonomisë së Kosovës

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), zhvillimet ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2025 karakterizohen nga një ritëm i moderuar i rritjes ekonomike dhe sinjale të lehta të ngadalësimit krahasuar me vitet paraprake.

Sipas të dhënave preleminare për vitin 2025¹, Bruto Produktit Vendor (BPV) me çmime aktuale në vitin 2025 ishte 11.026,3 milionë euro, që paraqet një rritja reale prej 3.62% krahasim me vitin 2024, duke reflektuar një performancë më të ulët se disa nga vitet e mëparshme të periudhës pas pandemisë.

BPV për koke banori për vitin 2025 arrinë në 6,954 euro², që paraqet një rritje nominale prej rreth 426 euro apo 6.5% krahasuar me vitin paraprak.

Figurat në vazhdim paraqesin trendin e normave të rritjes reale së BPV-së vjetore në %, krahasuar me periudhën përkatëse të viteve paraprak.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Analiza e të dhënave për periudhën 2010 - 2025 tregon se ekonomia e Kosovës ka kaluar nëpër disa faza të dallueshme ciklike. Pas një rritjeje relativisht të qëndrueshme në dekadën 2010 deri 2019, ekonomia përjetoi një tkurrje të theksuar në vitin 2020 me -5.34%, si pasojë e krizës globale të shkaktuar nga pandemia, e shoqëruar me rënie të konsiderueshme të eksporteve dhe investimeve. Me pastaj u pasua nga një rimëkëmbje e fortë në vitin 2021 me 10.75% e nxitur nga rikthimi i konsumit dhe zgjerimi i tregtisë së jashtme. Në vitet pasuese, ritmi i rritjes gradualisht u stabilizua, duke kaluar në një trajektore më të moderuar prej rreth 4.1 deri 4.6%, derisa në vitin 2025 u regjistrua një nivel më i ulët prej 3.62%.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), publikim dt. 13 mars 2026, Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM4 2025,

² Kalkulimi BPV për koke banori për vitin 2025, bazohet në parashikimet për numrin e pupullësin viti 2024 prej 1,585,590 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Tabela në vazhdim paraqet normat e rritja reale dhe kontributin sipas komponentëve kryesore të BPV-së me qasjen e shpenzimeve nëpër vite,

TM	BPV reale, në %, (v-m-v)	Konsumi privat	Konsumi publik	Investimet totale	Eksporti (M&SH)	Importi (M&SH)
2015	5.92%	0.88%	0.27%	2.79%	0.43%	1.54%
2016	5.57%	3.19%	-0.98%	4.98%	2.33%	-3.95%
2017	4.83%	2.48%	0.17%	0.19%	4.77%	-2.79%
2018	3.41%	3.46%	0.83%	2.43%	2.48%	-5.79%
2019	4.76%	4.50%	1.22%	-0.58%	2.19%	-2.58%
2020	-5.34%	1.99%	0.26%	-2.47%	-8.53%	3.40%
2021	10.75%	6.21%	1.26%	3.58%	16.65%	-16.95%
2022	4.28%	2.86%	0.03%	-1.37%	6.31%	-3.55%
2023	4.07%	2.69%	0.70%	1.24%	2.79%	-3.35%
2024	4.57%	4.61%	0.17%	2.15%	3.74%	-6.09%
2025*	3.62%	2.88%	0.92%	2.89%	3.19%	-6.30%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Rritja reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve, tregon se rritja ekonomike në vitin 2025 është mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet ndërsa dinamika e sektorit të jashtëm ka pasur një ndikim më kompleks të dyanshëm. Kontributi i sipas komponentëve kryesorë të BPV-së në vijm:

Konsumi privat (me 2.88%), Konsumi privat mbetet shtylla kryesore e rritjes ekonomike duke kontribuar me 2.88 p.p. duke reflektuar rritjen e të ardhurave të disponueshme, remitancat dhe stabilitetin relativ të tregut të punës. Megjithatë, norma e rritjes është më e moderuar krahasuar me periudhat e rimëkëmbjes pas pandemisë.

Konsumi publik (me 0.92%), Shpenzimet e sektorit publik kontribuan në rritjen ekonomike, por në një shkallë relativisht të kufizuar.


Investimet totale (me 2.89%), Investimet shfaqin një përmirësim të moderuar kontribut ne rritje me 2.89 p.p. duke reflektuar zgjerimin e investimeve në sektorët e ndërtimit dhe infrastrukturës, megjithatë, niveli i tyre mbetet ende në nivele më të ulët krahasuar me vitete me dinamizëm më të madh investimesh.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve (me 3.19%), Eksportet shënuan një rritje të moderuar, me kontribut ne rritje prej 3.19 p.p. duke treguar një zgjerim gradual të integritimit tregtar dhe të aktiviteteve prodhuese, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe industrisë përpunuese.

Importet e mallrave dhe shërbimeve (me -6.30%), Importet vazhdojnë të kenë një ndikim negativ në rritjen e BPV-së, e kundërveprua rritjen me me -6.30 p.p. për shkak të peshës së lartë të konsumit të mallrave të importuara.


Nëse analizojmë dinamika e rritjes së BPV-së në vitin 2025, shohim se rritja nuk ishte homogjene, ajo ishte me luhatje ciklike brenda vitit përgjatë tremujorëve: te tremujori i parë (TM1) kemi rritje prej 3.01%, në (TM2) vërehet një përsheptim në 4.53%, në (TM3) pason një ngadalësim rënie në 3.08% dhe TM4 stabilizohet në rreth 3.85%.

Figurat në vazhdim paraqesin trendin e normave të rritjes reale së BPV-së tremujore në %, krahasuar me periudhën përkatëse të viteve paraprak.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Figura në vazhdim paraqet rritja reale sipas komponentëve kryesore të BPV-së me qasjen e shpenzimeve nëpër tremujor,



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në përgjithësi, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se ekonomia e Kosovës vazhdon të rritet, por me ritëm më të ngadalët krahasuar me periudhën e rimëkëmbjes pas pandemisë. Rritja mbështetet kryesisht nga konsumi privat dhe në një masë më të vogël nga investimet, ndërsa sektori i jashtëm dhe dinamika e importeve reflektojnë ndryshime në strukturën e kërkesës agregate.

Analiza e të dhënave sipas **aktivitetet ekonomike**, tregon se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje reale (v-m-v) në disa sektorë kyç, duke reflektuar një dinamikë të lehtë në aktivitetin ekonomik të vendit.

Sektoret- aktivitetet ekonomike që kanë pasur rritje gjatë vitit 2025, janë: Aktivitete financiare dhe të sigurimit me 6.9%, Ndërtimtaria me 5.7%, Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike, aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 4.9%, Arte, zbavitje dhe rekreacion 4.7%, Hotelet dhe restorantet me 4.5%, Tregti me shumicë dhe pakicë, si dhe riparim i automjeteve dhe motoçikletave 4.0%, Industria përpunuese 3.9% dhe Aktivitete administrative dhe mbështetëse 3.9%, Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim me 3.5%, Informim dhe komunikim 3.6%, Transport dhe magazinim me 3.3%, Furnizimi me ujë 3.1%, Industria nxjerrëse rritje me 2.7%, Shërbime të tjera 2.6%, Edukim 2.2%, Shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale 1.7%, Administrim publik dhe i mbrojtjes, si dhe sigurim i detyrueshëm social 1.0%; Afarizëm me pasuri të patundshme 0.8%.

Aktivitete ekonomike me rënie gjatë vitit 2025 ishte sektori Furnizim me energji elektrike, me gaz me -16.9% krahasuar me periudhën e njëjtë vitit paraprak.

Nga krahasimi i të dhënave në vlerë dhe strukturuar në përqindje, shihet se BPV sipas aktiviteteve ekonomike për vitin 2025 dominohet nga: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave merr pjesë me rreth 1,551.6 milionë euro apo 14.1%, pasuar nga Industria përpunuese me rreth 1,382.0 milionë euro apo 12.5%, Ndertimtaria me 860.4 milionë euro apo 7.8%, sektor i Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi me rreth 811.5 milionë euro apo 7.4%, Afarizmi me pasuri të patundshme me rreth 591.7 milionë euro apo 5.4%, etj. pjesëmarrja në raport me totalin (11.026.3 milionë euro) e Bruto Produktit Vendor me çmime aktuale në vitin 2025.

Inflacioni mujor dhe vjetor


Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)³ si parametër statistikor, ndryshe njihet edhe si Indeksi i Kostos së Jetesës, gjithashtu merret edhe si parametër për matjen e Inflacionit.

³ Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) i Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, të definuara nga Eurostat. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 91 klasa konsumi të definuar (në nivel 4-shifror) më tutje në 420 produkte (agregat

Bazuar në të dhënat e publikuara nga ASK, Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në fund të vitit 2025, është më i lartë në një mesatare prej 5.3% në muajin Dhjetor 2025 krahasuar me muajin Dhjetor 2024.

Normat mujore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Nga grafiku shihet se gjatë periudhës janar - dhjetor 2025, kemi një trend rritës të Indeksit të çmimeve të konsumit (IHCK) me një **mesatare vjetore prej 3.9%** (në janar 1,5 %, deri në dhjetor 5.3%) krahasuar me muajt përkatës të vitit 2024.


Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafe, çaj dhe kakao (15,2 %); shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (11,6 %); pemë (11,5 %); energji elektrike (11,4 %); mish (11,0 %); pushime të organizuara (10,3 %); mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve personale të transportit (9,2 %); vajra dhe yndyra (8,4 %); qumësht, djathë dhe vezë (7,2 %); shërbime hoteliere (7,0 %); shërbime ambulatore (6,3 %); perime (5,9 %); pije alkoolike (5,3 %); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,2 %); gazeta, libra dhe materiale për zyra (5,1 %); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (4,8 %); pajisje terapeutike (4,7 %); kujdes personal (4,6 %); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (4,0 %); duhan (3,9 %); bukë dhe drithëra (3,8 %); prodhime ushqimore (3,6 %); shërbime financiare (3,4 %); furnizim me ujë dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3,2 %); këpucë (3,0 %); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (3,0 %); veshje (2,6 %); gjëra personale (2,6 %); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (1,8 %); bileta të transportit rrugor (1,8 %); mobilie dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (1,5 %); dhe ndryshime të çmimeve të produkteve dhe

elementarë). ASK ka përcaktuar peshtë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë. Çmimet konsumit mbledhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 14 Komuna të Kosovës.

shërbimeve te disa nëngrupe me një ndikim të vogël në IHÇK, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 4,1 për qind në IHÇK.

Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-4,6 %) me një ndikim prej (-0,3 për qind) në IHÇK.

Normat vjetore të inflacionit në përqindje të matura nga IHÇK-it



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Ndryshimet e çmimeve për grupet dhe nëngrupet

Nga tabela vijuse pasqyrohen lëvizjet e çmimeve te grupet dhe nëngrupe kryesor të artikujve si: 01-Ushqime dhe pije joalkoolike me rritje 7.6%, pasuar nga lëvizja e çmimeve te grupet 11-Restorante dhe hotele me rritje 6.8%, 06-Shëndeti me rritje 4.8%, 02-Pije alkoolike, duhan me rritje 4.4%, 04-Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera me rritje 4.1%, etj. mallra dhe shërbime qe kanë rol përcaktues të ndikimit në ndryshimet mujore dhe vjetore me rreth $\frac{3}{4}$ të ndikimit në ndryshimet mujore dhe vjetore.

Peshat për grupe dhe nëngrupet dhe ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it.

COICOP Grupe dhe nëngrupet	Peshat 2025 në %	XII- 2025 2015=100	XII-2025 IX-2025	XII- 2025 XII- 2024	Ideksi mesat. vjetor 2025 2015=100	2025 2024
00. IHÇK Total	1,000.00	138.2	0.7	5.3	135.1	3.9
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	321.1	161.0	0.6	8.6	156.3	7.6
02. Pije alkoolike, duhan	62.2	150.5	0.1	6.2	146.9	4.4
03. Veshje dhe këpucë	44.2	113.7	1.0	3.5	111.7	2.7

04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	89.9	138.5	3.7	10.7	128.6	4.1
05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinë të shtëpisë	72.8	126.9	0.0	2.4	125.8	2.7
06. Shëndeti	25.7	124.5	0.0	6.3	121.9	4.8
07. Transporti	183.6	118.9	0.4	0.3	118.7	-1.4
08. Mjete Komunikimi	31.9	112.0	0.0	-0.3	112.1	-1.4
09. Rekreacion dhe kulturë	58.3	108.6	0.1	1.0	108.8	1.8
10. Arsimi	8.8	108.1	0.0	3.8	107.6	3.3
11. Restorante dhe hotele	41.0	142.7	0.2	8.5	139.1	6.8
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	60.5	125.5	0.2	3.4	123.7	3.2

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)


Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) të Kosovës

Tregtia e jashtme e mallrave eksporti-importi, janar - dhjetor 2025

Sipas të dhënave mujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për periudhën Janar-Dhjetor 2025, deficitin tregtar për Kosovë ka shënuar një rritje prej 13.3% në raport me periudhën e njëjtët të vitit paraprak, duke arritur në -6,106.3 milion euro nga -5,388.6 milion euro në vitin 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka rënë në 13.4% nga 14.9% sa ishte në 2024.

Figura në vijim është paraqitur Bilanci tregtar i mallrave në periudhën Janar-Dhjetor sipas viteve në milion Euro.

Bilanci tregtar i mallrave Janar-Dhjetor, sipas viteve në milion Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Analizuar në periudhën e fundit katërvjeçare 2022-2025, Në vitin 2025, **Exporti** ka regjistruar një trend në rënie, në vlerat prej 942.1 milionë euro, apo rreth 0.2% më pakë se periudha e njëjtë e vitit 2024, (rënie të lehtë i eksporteve nga 997.8 milion euro në v.2022, në rreth 942.1 milion euro në v.2025). Ndërsa krahasuar në sasi (neto kg), për periudhën raportuese exporti i mallrave shënoi rritje për rreth 24.6 mijë tonë, apo rreth 3.2% më shumë sasi(kg) krahasuar me periudhën e njëjtë te vitit paraprak, qe mund të jetë ndikuar nga lloji i mallrave te exportuara.

Në periudhën Janar Dhjetor 2025, **Importi** i mallrave arrinë në 7,048.3 milion Euro apo 11.3% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak. Importet ka një trendë te vazhdueshëm rritës nga 5,639.4 milion euro (v. 2022) në rreth 7,048.3 milion euro (v. 2025). Analizuar në sasi (neto kg), importi i rregullt i mallrave shënoi rritje për rreth 445.8 mijë tonë, apo rreth 8.18% më shumë sasi(kg) krahasuar me periudhën e njëjtë te vitit paraprak.

Si rezultat i këtij trendi të rritjes së vazhdueshme të importeve në raport me eksportet, deficitit tregtar i mallrave vazhdon të thellohet nga viti në vit. Në terma vjetorë për periudhën 2022-2025, ky deficit ka shënuar një rritje mesatare vjetore prej rreth 12.2% (v-m-v), duke reflektuar një varësi të lartë nga mallrat e importuara dhe një kapacitet të kufizuar të prodhimit vendor për të përmbushur kërkesën e brendshme apo për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare.

Në tabelën në vijim është paraqitur bilanci tregtar i mallrave për vitet e fundit, i shprehur në milionë euro, së bashku me përqindjen e mbulueshmërisë së importeve me eksporte dhe normën e rritjes vjetore (v-m-v).

Bilanci tregtar i mallrave Janar-Dhjetor, sipas viteve në milion Euro, në % mbulushëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	997.8	873.6	944.3	942.1
Import	5,639.4	5,437.4	6,332.9	7,048.3
Bilanci tregtar	(4,641.6)	(4,563.8)	(5,388.6)	(6,106.3)
% e mbulimit	17.7%	16.1%	14.9%	13.4%
Exp. % v-m-v	33.1%	-12.4%	8.1%	-0.2%
Imp. % v-m-v	21.2%	-3.6%	16.5%	11.3%
Bila. Treg. % v-m-v	18.9%	-1.7%	18.1%	13.3%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë



Exportet Janar Dhjetor 2025, 10 Top vendet kryesore në %


Në periudhën Janar Dhjetor 2025, **Exporti i mallrave** ka një trend në rënie duke regjistruar vlerat prej 942.1 milion Euro, rënie për rreth 0.2% më pakë se periudha e njëjtë e vitit 2024.

Partnerët kryesorë te exporti i mallrave janë: Shqipëria me 17.0%, Maqedonia e Veriut me 14.7%, Gjermania me 11.4%, Zvicra me 10.5%, Serbia me 6.5% Mali i Zi me 6.0%, etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.

Exportet sipas grupeve kryesore - Sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës gjatë periudhës Janar Dhjetor 2025, exportet nga Kosova kanë këtë përbërje: Metalet bazë dhe artikujt prej tyre 22.2%; Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani 12.4%, Plastika, goma dhe artikuj prej tyre 12.1%; Artikujt të ndryshëm të prodhuar (kryesisht mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj.) 10.3%; Produkte minerale 9.5%; Tekstil dhe artikujt tekstili 6.6% dhe Tjera rreth 26.9% të vlerës së përgjithshme të exporteve. Bazuar në këto të dhëna shihet se, struktura e eksporteve mbetet e përqendruar në produkte me përpunim të ulët, çka nënvizon nevojën për diversifikim të bazës prodhuese dhe rritje të vlerës së shtuar të mallrave të eksportuara.

Figura në vijim paraqet exportet e Kosovës, për Janar Dhjetor 2024 2025 sipas sektorëve të grupeve kryesore si përqindje e vlerës së përgjithshme të exporteve.

Exportet Janar Dhjetor 2024 2025, sipas sektorëve të grupeve kryesore në %




Burimi: Doganat e Kosovës (DK), <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>

Importet Janar Dhjetor 2025, nga 10 Top vendet kryesore në %

Importi i mallrave arrinë në 7,048.3 milion Euro apo 11.3% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak.

Partnerët kryesorë të importi i mallrave janë: Gjermania me 14.3%, Turqia me 13.3% dhe Kina me 13.1%, pasuar nga Italia me 5.2%, Maqedonia e V. me 5.0%, Shqipëria me 4.1%, Greqia me 4.0%, Polonia me 3.9%, Serbia me 3.3% etj. si pjesëmarrje në vlerën e përgjithshme të importeve.




Importet sipas grupeve kryesore - Sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës, importet vazhdojnë të dominohen nga sektorë-grupe kapitujë kryesor si: Produktet minerale me 14,0%; Mjetet e transportit me 12,3%; Makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike me 12.2%; Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani 12.1%; Metalet bazë dhe artikujt prej tyre me 9.4%; Produktet industriale kimike apo industriale të lidhjeve me 7.6% dhe Tjera 32.4% të vlerës së përgjithshme të importeve.

Rritja e importeve në përgjithësi tregon rritjen e konsumit të brendshëm, ndërsa rritja te sektoret si produkteve minerale dhe mjeteve të transportit mund të jetë ndikuar nga rritja e kërkesës për energji dhe investime në infrastrukturë gjatë vitit 2025.

Figuar në vijim ofrojnë një përmbledhje të importeve të Kosovës, për periudhën Janar Dhjetor 2024 2025 sipas sektorëve të grupeve kryesore si përqindje e vlerës së përgjithshme të importeve.

Importet Janar Dhjetor 2024 2025, sipas sektorëve të grupeve kryesore në %

Importet Janar Dhjetor, sipas sektorëve të grupeve kryesore në %




Burimi: Doganat e Kosovë (DK), <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>

Eksportet e mallrave Eksportet me vendet e BE-së

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 316.2 milionë euro, ose rreth 33.6% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 1.2% krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

Exportet Janar Dhjetor 2024 2025, në vendet e BE-së milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët kryesorë të eksporti i mallrave në këtë periudhë në BE-së janë: Gjermania me 11.4%, Italia me 3.1%, Holanda me 3.0%, Franca 2.3%, Bullgaria me 2.0%, Austria me 1.6%, etj., si përqindje e vlerës së përgjithshme të eksporteve.

Eksportet në vendet e BE-së sipas viteve milionë euro dhe përqindja si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, tabela në vijim.


EXPORTE në vendet BE-së	2022		2023		2024		2025	
	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>	<i>në vlerë</i>	<i>në %</i>
Gjermania	87.8	8.8%	93.6	10.7%	100.7	10.7%	107.1	11.4%
Italia	46.4	4.6%	38.7	4.4%	37.4	4.0%	28.9	3.1%
Hollanda	29.1	2.9%	27.2	3.1%	25.3	2.7%	28.6	3.0%
Austria	15.5	1.5%	20.2	2.3%	23.6	2.5%	15.5	1.6%
Franca	14.3	1.4%	16.2	1.8%	20.3	2.2%	21.5	2.3%
Belgjike	16.0	1.6%	17.0	1.9%	17.1	1.8%	14.4	1.5%
Bullgaria	12.7	1.3%	9.9	1.1%	14.5	1.5%	18.5	2.0%
Spanja	1.7	0.2%	5.7	0.7%	13.0	1.4%	9.5	1.0%
Kroacia	10.0	1.0%	9.1	1.0%	12.2	1.3%	13.8	1.5%
Suedia	4.9	0.5%	5.5	0.6%	7.5	0.8%	9.0	1.0%
Slovenia	40.3	4.0%	3.6	0.4%	7.6	0.8%	4.6	0.5%
Rumania	3.3	0.3%	4.6	0.5%	6.7	0.7%	7.2	0.8%
Greqia	5.0	0.5%	6.4	0.7%	6.5	0.7%	9.5	1.0%
Tjera të BEsë	35.5	3.6%	21.0	2.4%	20.1	2.1%	28.1	3.0%
Gjithsej BE	322.4	32.3%	278.7	31.9%	312.6	33.1%	316.2	33.6%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Eksportet me vendet e CEFTA

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 431.5 milionë euro, ose 45.8% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje të lehtë prej 0.6% krahasuar me periudhën e njejtë të vitit paraprak.

Exportet Janar Dhjetor 2024 2025, në vendet e CEFTA, në milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët kryesorë të Kosovës për exportin e mallrave në vendet e CEFTA-së gjatë periudhës së analizuar janë: Shqipëria me 17.0%, Maqedonia e Veriut me 14.7%, Serbia me 6.5%, Mali i zi me 6.0%, dhe B&H me 1.6%, si përqindje e vlerës së përgjithshme të exporteve.

Tablat në vazhdim paraqet eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA sipas viteve milionë euro dhe si përqindje e vlerës së përgjithshme të exporteve.

EXPORTE në vendet CEFTA	2022		2023		2024		2025	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Shqipëria	168.6	16.9%	125.2	14.3%	171.0	18.1%	159.9	17.0%
Maqedonia e Veriut	119.2	11.9%	121.6	13.9%	146.1	15.5%	138.5	14.7%
Serbia	62.9	6.3%	49.6	5.7%	53.3	5.6%	61.5	6.5%
Mali i Zi	38.3	3.8%	45.0	5.1%	44.5	4.7%	56.8	6.0%
Bosnia dhe Herzegovina	11.4	1.1%	12.4	1.4%	13.9	1.5%	14.6	1.6%
Moldavi	0.0	0.0%	0.1	0.0%	0.3	0.0%	0.2	0.0%
Gjithsej	400.3	40.1%	353.9	40.5%	428.9	45.4%	431.5	45.8%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA dhe vendet tjera të botës

Në periudhën Janar - Dhjetor 2025, eksportet e Kosovës te vendet tjera (jashtë BE 27 dhe CEFTA) arritën në 194.3 milionë euro, ose 20.6% e vlerës së përgjithshme të exporteve. Exportet e mallrave

te vendet e BE-së janë në vlerë 316.2 milionë euro, vendet e CEFTA në vlerë 431.5 milionë euro, Zvicër në vlerë 99.4 milionë euro, Turqi në vlerë 33.2 milionë euro, SHBA në vlerë 24.4 milionë euro dhe Tjera 37.4 milionë euro.

Exportet e Kosovës Janar Dhjetor 2024 2025, në milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar të exporteve të Kosovës sipas grupeve kryesore tregtare CEFTA, BE-së dhe vendet Tjera për 2022-2025. Të dhënat janë paraqitur në milionë euro dhe si përqindje e pjesëmarrjes në exportin e përgjithshëm.


EXPORTE	2022		2023		2024		2025	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
CEFTA	400.3	40.1%	353.9	40.5%	428.9	45.4%	431.5	45.8%
BE	322.4	32.3%	278.7	31.9%	312.6	33.1%	316.2	33.6%
ZVICER	70.1	7.0%	75.6	8.7%	86.3	9.1%	99.4	10.5%
SHBA	136.5	13.7%	106.3	12.2%	39.6	4.2%	24.4	2.6%
TURQI	23.5	2.4%	20.2	2.3%	27.5	2.9%	33.2	3.5%
Tjera	45.0	4.5%	38.7	4.4%	49.4	5.2%	37.4	4.0%
Gjithsej	997.8	100.0%	873.6	100.0%	944.3	100.0%	942.1	100.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët më të rëndësishëm për exportin e mallrave te vendet tjera (jashtë BE 27 dhe CEFTA) janë: Zvicra me 10.5%, Turqi me 3.5%, SHBA me 2.6% dhe Tjera 4.0%, si përqindje e vlerës së përgjithshme të exporteve.

Figura në vazhdim paraqet mesataren në përqindje të eksporti i mallrave sipas vendeve kryesore, të për periudhën katërvjeçare 2022-2025.

Exportet Janar Dhjetor 2022-2025, sipas vendeve kryesore,



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK), <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>


Gjatë periudhës katërvjeçare 2022-2025, exportet e mallrave kanë ndjekur një trend në luhajtje me ngritje ulje të lehta. Sa i përket strukturës sipas vendeve kryesore, vendat nga CEFTA mbetën partneri kryesor me rritje të qëndrueshme në vlerë dhe në përqindje (nga 40.1% në 2022, në 45.8% në 2025), exportet në vendet e Bashkimit Evropian (BE) mbetet tregu i dytë kryesor (rreth 32–34%), me luhajtje të moderuara por relativisht stabile. Zvicra shënon rritje të vazhdueshme si në vlerë ashtu edhe në peshë (nga 7.0% në 10.5%), duke fituar rëndësi strategjike. Te SHBA kemi një trend rënie të fortë strukturore (nga 13.7% në 2022, në vetëm 2.6% në 2025), që tregon t'kurrije të ndjeshme të këtij tregu. Exportet për në Turqi kanë trend gradual rritës, por me pjesëmarrje ende të kufizuar derisa tregjet (vendet) Tjera (rreth 4.5%), mbeten relativisht stabile me luhajtje të vogla, si përqindje e vlerës së përgjithshme të eksporteve.

Kjo strukturë tregon për një përqendrim rajonal dhe evropian, me prani të moderuar në tregjet ndërkombëtare. Ndryshe nga importet që janë në rritje të vazhdueshme, eksportet karakterizohen nga paqëndrueshmëri dhe nivel i përgjithshëm më i ulët krahasuar ndër vite.

Importet e mallrave Importet nga vendet e BE-së

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, importet e Kosovës nga vendet e BE-së arritën në 3,036.8 milionë euro, ose rreth 43.1% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 7.1% krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

Importet Janar Dhjetor 2024/2025, nga vendet e BE-së milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët kryesorë të importi i mallrave në BE-së janë: Gjermania me 14.3%, Italia me 5.2%, Greqia me 4.0%, Polonia me 3.9%, Sllovenia 1.8%, Kroacia me 1.6% etj, si përqindje e vlerës së përgjithshme të importeve.

Importet në vendet e BE-së sipas viteve, në milionë euro dhe përqindja si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, tabela në vijim.

IMPORTE nga vendet BE-së	2022		2023		2024		2025	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Gjermania	610.4	10.8%	682.6	12.6%	890.5	14.1%	1,008.3	14.3%
Italia	275.9	4.9%	287.5	5.3%	330.9	5.2%	369.4	5.2%
Greqia	307.3	5.5%	301.2	5.5%	315.4	5.0%	279.1	4.0%
Polonia	135.1	2.4%	140.4	2.6%	208.6	3.3%	272.7	3.9%
Kroacia	102.2	1.8%	105.1	1.9%	134.6	2.1%	115.4	1.6%


Slovenia	243.6	4.3%	117.7	2.2%	120.7	1.9%	129.4	1.8%
Bullgaria	94.3	1.7%	88.1	1.6%	131.9	2.1%	113.4	1.6%
Hungaria	86.2	1.5%	73.1	1.3%	103.7	1.6%	77.6	1.1%
Austria	84.6	1.5%	81.6	1.5%	99.7	1.6%	110.6	1.6%
Franca	81.6	1.4%	67.9	1.2%	93.9	1.5%	102.0	1.4%
Rumania	64.6	1.1%	73.0	1.3%	85.7	1.4%	92.4	1.3%
Hollanda	48.6	0.9%	45.8	0.8%	59.7	0.9%	55.7	0.8%
Spanja	60.3	1.1%	58.3	1.1%	58.6	0.9%	83.5	1.2%
Cekia	53.7	1.0%	68.2	1.3%	62.4	1.0%	78.1	1.1%
Tjera të BE së	140.5	2.5%	114.8	2.1%	140.5	2.2%	149.1	2.1%
Gjithsej	2,388.8	42.4%	2,305.4	42.4%	2,836.7	44.8%	3,036.8	43.1%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Importet nga vendet e CEFTA

Në periudhën Janar - Dhjetor 2025, importet e Kosovës nga vendet CEFTA-së arritën në 968.2 milionë euro, ose 13.7% të importeve të përgjithshme, kjo paraqet një rritje rreth 14% krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

Importet Janar Dhjetor 2024 2025, nga vendet e CEFTA, në milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët kryesorë të Kosovës për importin e mallrave nga vendet e CEFTA-së gjatë periudhës së analizuar janë Maqedonia e Veriut me një pjesëmarrje prej 5.0%, Shqipëria me 4.1% dhe Serbia me 3.3%, si përqindje e vlerës së përgjithshme të importeve.

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar të importeve të Kosovës nga vendet e CEFTA-së, sipas viteve (në milionë euro), së bashku me përqindjen që ato zënë në totalin e importeve të përgjithshme.


IMPORTE nga vendet CEFTA	2022		2023		2024		2025	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
Shqipëria	255.9	4.5%	310.9	5.7%	338.2	5.3%	286.7	4.1%
Maqedonia e Veriut	282.1	5.0%	294.9	5.4%	297.7	4.7%	351.7	5.0%
Serbia	372.1	6.6%	192.7	3.5%	129.7	2.0%	234.6	3.3%
Mali i Zi	24.1	0.4%	28.6	0.5%	25.9	0.4%	41.3	0.6%
Bosnia dhe Hercegovina	66.1	1.2%	57.3	1.1%	58.7	0.9%	52.7	0.7%
Moldavi	0.5	0.0%	0.7	0.0%	1.2	0.0%	1.3	0.0%
Gjithsej	1,000.7	17.7%	885.2	16.3%	851.5	13.4%	968.2	13.7%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Importet nga vendet e BE-së , CEFTA dhe vendet tjera të botës

Në periudhën Janar-Dhjetor 2025, importet e Kosovës me vendet tjera (jashtë BE 27 dhe CEFTA) arritën në 3,043.2 milionë euro, ose 43.2% të importeve të përgjithshme. Importe te mallrave nga vendet e BE-së janë në vlerë 3,036.8 milionë euro, vendet e CEFTA në vlerë 968.2 milionë euro, nga Turqia në vlerë 935.8 milionë euro, nga Kina 922.5 milionë euro, nga Arabia Saudite 183.6 milionë euro nga SHBA 106.3 milionë euro dhe Tjera 895.0 milionë euro.

Importet e Kosovës Janar Dhjetor 2024 2025, në milionë euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar të importeve të Kosovës sipas grupeve kryesore tregtare – CEFTA, BE-së dhe vendet Tjera nëpër vite 2022-2025. Të dhënat janë paraqitur në milionë euro dhe si përqindje e pjesëmarrjes në importin e përgjithshëm, duke mundësuar analizimin e tendencave dhe ndryshimeve në orientimin tregtar të Kosovës gjatë viteve të fundit.


IMPORTE	2022		2023		2024		2025	
	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %	në vlerë	në %
CEFTA	1,000.7	17.7%	885.2	16.3%	851.5	13.4%	968.2	13.7%
BE	2,388.8	42.4%	2,305.4	42.4%	2,836.7	44.8%	3,036.8	43.1%
Turqia	843.0	14.9%	796.6	14.6%	905.2	14.3%	935.8	13.3%
Kina	548.6	9.7%	594.0	10.9%	756.2	11.9%	922.5	13.1%
Arabia Saudite	218.1	3.9%	21.4	0.4%	184.7	2.9%	183.6	2.6%
SHBA	71.9	1.3%	86.3	1.6%	106.7	1.7%	106.3	1.5%
Tjera	568.3	10.1%	748.6	13.8%	692.0	10.9%	895.0	12.7%
Gjithsej	5,639.4	100.0%	5,437.4	100.0%	6,332.9	100.0%	7,048.3	100.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Partnerët më të rëndësishëm për importin e mallrave janë vendet e BE-së, vendet e CEFTA, Turqia dhe Kina. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, janë importuar mesatarisht rreth 43.1% nga vendet e BE-së dhe 13.7% nga vendet e CEFTA-së, pjesa tjetër nga vendet si Turqia me 13.3%, nga Kina 13.1%, nga Arabia Saudite 2.6%, nga SHBA me 1.5% dhe Tjera 12.7% si përqindje e vlerës së përgjithshme të importeve.

Figura në vazhdim paraqet mesataren në përqindje të importit të mallrave sipas vendeve kryesore, të periudhës katërvjeçare 2022-2025.

Importet Janar Dhjetor 2022-2025, sipas vendeve kryesore,



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK), <https://dogana.rks-gov.net/OpenData/Index?id=4>

Gjatë periudhës katërvjeçare 2022 - 2025, importet e mallrave kanë ndjekur një trend rritës. Sa i përket struktues sipas vendeve kryesore, vendet e Bashkimit Evropian (BE) mbeten partneri dominues (me rreth 43 deri 45% e vlerës së përgjithshme të importeve), dhe me rritje të vazhdueshme në vlerë. Kina shënon rritjen më të dukshme strukturore (nga 9.7% në 2022, në 13.1% në 2025). Turqia rritet në vlerë, por me peshë relativisht stabile (rreth 14%). Importet nga vendet e CEFTA tregojnë rënie graduale në peshë specifike (nga 17.7% në 2022, në 13.7% në 2025), derisa importet nga Arabia Saudite dhe SHBA mbetet me peshë të vogël si përqindje e vlerës së përgjithshme të importeve.

Kjo strukturë tregon për një përqendrim rajonal dhe evropian, pasqyron një zgjerim të vlerës total të importeve me forcim të rolit nga vendet e BE-së, por edhe rritje importit nga Kinës, e vendet tjera në tregjet ndërkombëtare si tendenë për rritje e diversifikimit të importit të mallrave.

Bilanci i Pagesave të Kosovës

Sipas të dhënave të Banka Qendrore e Kosovës (BQK), trendi i përgjithshëm gjatë periudhës 2021-2025 shfaq një tendencë në rritje të deficitit (nga -632.5 milione euro në 2021, në -976.4 në 2025 milione euro). Për periudhën Janar-Dhjetor 2025, bilanci i pagesave të Kosovës ka shënuar një rritje prej 16.1% në raport me periudhën e njëjtët të vitit paraprak, duke arritur në -976.4 milion euro nga -841.0 milion euro sa ishte në periudhën e njëjtët të vitit 2024.


Në tabelën në vijim është paraqitur Bilanci nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale në periudhën Janar-Dhjetor sipas viteve në milion Euro.

në milionë euro	Bilanci nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale	Llogaria rrjedhëse	Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore	Llogaria kapitale
Viti	1= (2+7)	2= (3+4+5+6)	3	4	5	6	7
2021	-632.51	-694.73	-3,567.05	1,034.85	151.37	1,686.10	62.21
2022	-781.87	-820.33	-4,209.86	1,372.93	115.51	1,901.09	38.47
2023	-636.11	-698.95	-4,586.92	1,629.27	198.91	2,059.80	62.83
2024	-840.97	-872.57	-4,926.82	1,791.39	245.99	2,016.87	31.60
2025	-976.40	-1,012.15	-5,575.51	2,233.22	256.17	2,073.97	35.75

Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Nga të dhënat trendi i bilancit karakterizohet nga luhajtje të theksuara duke vazhduar një përkeqësim të ndjeshëm me rreth 23.6% për vitin 2022, një përmisim të dukshëm në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak (por ende mbetet në vlerat negative prej rreth -636.1 milionë euro). Në dy vitet e fundit vazhdon trendi negative, deficit thellohet për rreth 32.2% vitin 2024 dhe 16.1% në vitin aktual, në fund të vitit 2025, deficiti i llogarisë rrjedhëse arrin vlerën më të lartë në këtë prej -976.4 milionë euro.

Figura në vijmë paraqet Bilanci e Pagesave të Kosovës,(bilanci nga llogaria rrjedhëse dhe kapitale) gjatë periudhës 2021-2025, në milionë euro dhe trend rritës në përqindje (v-m-v).




Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Investimet e Huaja Direkte (neto) në Kosovë

Sipas të dhënave të Banka Qendrore e Kosovës (BQK), trendi i përgjithshëm i Investimeve të Huaja Direkte (neto) në Kosovë vazhdon të mbajë një trend rritës, gjatë periudhës katërvjeçare.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 arrin në 1,031.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 30.0% krahasuar me periudhën e njejtë të vitit 2024, (ky ndryshim vjenë edhe për arsye se BQK në publikim e fundit i ka rishikaur për me ultë të dhënat për vitin 2024).


Figura në vijmë paraqet Investimeve të Huaja Direkte (neto) gjatë periudhës 2021-2025, në milionë euro dhe trend rritës në përqindje (v-m-v).



Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Investimet vazhdojnë të dominohen nga aktivitetet e Patundshmërisë, të cilat përfaqësojnë 74.6% të totalit, përkatësisht 770.0 milionë euro, duke reflektuar vazhdimësinë e orientimit të kapitalit drejt pasurive të paluajtshme, në vendin e dytë renditet sektori Aktivitete financiare dhe të sigurimit me 12.1% (124.8 milionë euro), pasuar nga Tregti me shumicë e pakicë, riparim i mjet.. me 3.1% (32.1 milionë euro), Informacion dhe komunikim me 2.5% (26.2 milionë euro), Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe me ajër të kondicionuar me 2.1% (22.1 milionë euro), Prodhimi me 1.7% (17.9 milionë euro) dhe Tjera me rreth 3.7% (rreth 38.6 milionë euro), çka tregon një tendenc te lehtë orjentimi të investimeve edhe te sektoret tjerë si financiar, prodhim dhe Furnizim me energji elektrike.


Investimet e Huaja Direkte (neto) në % , viti 2025



Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Ndër sektorët tjerë me pjesëmarrje më të ulët në këtë vite janë: aktivitetet, Ndertimtari me 0.9% (8.9 milionë euro), Xehetaria dhe guroret(5.4 milionë euro) etj.

Figura në vijmë paraqet Investimeve të Huaja Direkte (neto) gjatë viteve 2021-2025, për dy sektorët kryesor.




Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Analizar sipas vendeve te origjinës në vitin 2025, IHD kryesohen nga vendet e BE 27. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve (neto), për periudhë janar dhjetor 2025 janë: nga Gjermania 26.0% përkatësisht 268.7 milionë euro, nga Zvicra me 21.7% (223.9 milionë euro), pasuar nga Shqiperia 10.0% (103.6 milionë euro), nga SHBA 9.0% (92.5 milionë euro), nga

Austria 5.8% (59.8 milionë euro), nga Suedia 4.8% (49.8 milionë euro), etj, si pjesëmarrjen në IHD e përgjithshëm.

Investimet e Huaja Direkte (neto) në Kosovë, sipas shteteve Janar Dhjetor 2024 - 2025, në milionë euro




Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Investimet Direkte të Kosovë (jashtë vendit)

Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), trendi i përgjithshëm i Investimeve Direkte të Kosovës jashtë vendit ka qenë rritës gjatë periudhës katërvjeçare 2021-2025. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 kemi një rritje e ndjeshme, investimet arritën në 366.9 milionë euro, milionë euro, kjo vlerë paraqet një rritje prej 63.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Figura në vijmë paraqet Investimeve Direkte Jashtë Vendit gjatë periudhës 2021-2025, në milionë euro dhe trend rritës në përqindje (v-m-v).




Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Dërgesat e migrantëve- Remitancat për në Kosovë

Sipas të dhënave të Banka Qendrore e Kosovës (BQK), trendi i përgjithshëm i dërgesave të migrantëve për në Kosovë vazhdon të mbajë një trend rritës gjatë periudhës katërvjeçare. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 arrin në 1,413.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 4.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.


Figura në vijmë paraqet Dërgesat e migrantëve gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021-2025, në milionë euro dhe trend rritës në përqindje (v-m-v).



Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për periudhën Janar Dhjetor 2025, Gjermania mbetet burimi kryesor i dërgesave nga diaspora, duke kontribuar me 38.7% të totalit, që përkthehet në rreth 547.4 milionë euro, pas saj renditet Zvicra me 17.7% (rreth 250.2 milionë euro), Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 7.3% (rreth 102.5 milionë euro), Austria me 4.2% (rreth 59.3 milionë euro), Italia me 3.8% (rreth 54.3 milionë euro), Franca me 3.4% (rreth 48.4 milionë euro) dhe Suedia e Belgjika me nga 3.3% (me nga rreth 47 milionë euro), etj. si pjesëmarrje në totalin e dërgesave të migrantëve gjatë vitit 2025.

Dërgesat e migrantëve sipas vendeve, për periudhën Janar - Dhjetor 2024 2025, në milionë euro,



Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Sipas të dhënave të fundit nga BQK, mënyrat përmes të cilave dërgohen remitencat janë kryesisht përmes Agjencive për transfer të mjeteve rreth 55.3%, përmes Bankave komerciale rreth 16.9% dhe forma Tjera⁴ alternative të transferimit të parave rreth 27.8%.

Dërgesat e migrantëve përbëjnë një pjesë të rëndësishme të të hyrave kombëtare dhe luajnë një rol kyç në zhvillimin ekonomik, duke kontribuar ndjeshëm në ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit. Ato kontribuojnë në mirëqenien e familjeve përfituese, nxisin konsumin, kursimet dhe investimet, si dhe ndihmojnë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik.

⁴ Në kategorinë “forma tjera alternative të transferimit të parave.”, përfshihen mënyra të ndryshme joformale për arsye praktike, më të zakonshme janë: (i) Dërgesat në dorë, Migrantët ose të afërmit e tyre i sjellin paratë fizikisht gjatë vizitave në Kosovë, veçanërisht gjatë pushimeve verore ose festave të ndryshme, kjo formë është e shpeshtë sepse shmang tarifën e transferit dhe lejon dhënie të drejtpërdrejtë të ndihmës; (ii) Përmes të afërmit ose miqve -paratë dërgohen me persona të besuar që udhëtojnë drejt Kosovës., zakonisht përdoret sidomos për shuma më të vogla, ku nuk shihet nevoja për një kanal formal apo (iii) Përmes llogarive të përbashkëta ose ndërmjetës bankare, në disa raste, migrantët përdorin llogaritë bankare të përbashkëta me familjarët për të shmangur kostot e transferit ndërkombëtar e te ngjashme.

Gjatë dekadës së fundit remitencat kanë përbërë mesatarisht nga 13% deri në 14% të Bruto Produktit Vendor (BPV), ky trend reflekton varësinë strukturore të ekonomisë nga diaspora. Kjo tendencë tregon se remitencat nuk janë vetëm burim likuiditeti për familjet përfituese, por edhe një instrument i qëndrueshëm për balancimin e deficitit tregtar dhe për mbështetjen e konsumit të brendshëm.

Të dhënat e detajuara për këtë komponent janë paraqitur në tabelën në vijim, ku janë shënuar dërgesat e migrantëve në milionë euro dhe përqindja përkatëse ndaj BPV-së gjatë periudhës si në tabele.

Dërgesat e migrantëve - Rremitancat në Kosovë	2021	2022	2023	2024	2025 *
Rremitancat (milion Euro)	1,153.4	1,222.8	1,335.8	1,355.0	1,413.7
Rremitancat si % e BPV	14.5%	13.7%	13.8%	13.1%	13.0%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

(*) për viti 2025, kalkulimi si % në raport me BPV lidhen parashikimin BPV për 2025,

Të Hyrat dhe Shpenzimet buxhetore,

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, vërehet një ritëm i qëndrueshëm i të Hyrave buxhetore, të cilat kanë arritur në 3,326.8 milionë euro, duke shënuar rritje prej 8.1% krahasuar me vitin 2024. Rritja është kryesisht e nxitur nga të hyrat tatimore, të cilat në strukturë përbëjnë 88.9% të totalit të hyrave buxhetore, prej tyre të tatimet direkte shënojnë rritje prej rreth 8.1% dhe tatimet indirekte rritje prej rreth 8.4%, ndërkohë, të hyrat jo-tatimore mbeten konstante.

Në anën e shpenzimeve, Shpenzimet buxhetore në 2025 arrijnë në 3,415.7 milionë euro, me rritje prej 10.0%. Rritja mbështetet kryesisht nga shpenzimet rrjedhëse me rritje prej 9.6%, të cilat në strukturë përbëjnë rreth 77.4% dhe Shpenzimet kapitale me rreth 21.1% të totalit të shpenzimeve buxhetore. Me konkretisht Paga dhe shtesa shënojnë rritje prej 8.0%, mallrat dhe shërbimet janë rritur me 10.0%, subvencionet dhe transferet janë rritur me 10.6% dhe shpenzimet kapitale me rreth 11.3% krahasuar me periudha e njëjtë e vitit 2024. Po ashtu, pagesat e interesit për borxhin publik rriten me 17.7%, reflektim i kostos së shërbimit të borxhit në kushtet aktuale fiskale.

Nga tabela vijuse pasqyrohen trendin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore periudhës Janar - Dhjetor 2022-2025, Ndryshimin 2025/2024 dhe Struktura në përqindje vitin aktual 2025.

Të Hyra buxhetore dhe Shpenzime buxhetore për Janar - Dhjetor 2022-2025


Përshkrimi (në milion Euro)	2022	2023	2024	2025	Ndryshimi (2025/2024)	Struktura 2025 në %
1.1 TË HYRAT BUXHETORE	2,483.8	2,840.3	3,078.1	3,326.8	8.1%	100.0%

1.1.1 Të hyrat tatimore	2,217.0	2,505.9	2,740.2	2,973.0	8.5%	88.9%
Tatimet Direkte	413.8	490.3	517.2	559.3	8.1%	16.7%
Tatimet Indirekte	1,870.2	2,076.9	2,297.1	2,490.4	8.4%	74.5%
Kthimet Tatimore	-67.1	-61.3	-74.1	-76.7	3.4%	-2.3%
1.1.2 Të hyrat jo-tatimore	256.5	266.9	337.9	339.4	0.4%	10.2%
1.1.3 Mbështetje buxhetore dhe grantet	10.3	67.5	0.0	14.4		0.4%
1.2 Pranimet Grantet e pëcaktuara të donatorëve	9.7	13.8	9.9	16.3	64.4%	0.5%
2.1 SHPENZIMET BUXHETORE	2,530.3	2,865.1	3,104.2	3,415.7	10.0%	100.0%
2.1.1 Shpenzimet rrjedhëse	2,076.0	2,268.5	2,414.0	2,644.8	9.6%	77.4%
Paga dhe shtesa	652.6	766.6	843.0	910.1	8.0%	26.6%
Mallra dhe shërbime	333.4	394.9	429.2	471.9	10.0%	13.8%
Shpenzime komunale	25.9	28.8	29.2	32.1	9.6%	0.9%
Subvencione dhe transfere	1,064.1	1,078.2	1,112.5	1,230.7	10.6%	36.0%
2.1.2 Shpenzimet kapitale	419.3	554.4	647.0	720.1	11.3%	21.1%
2.1.3 Shpenzimet e interesit për borxh publik	35.0	42.2	43.2	50.9	17.7%	1.5%
2.2 Pagesat Grantet e pëcaktuara të donatorëve	10.0	11.9	19.7	15.67	-20.6%	0.5%

Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Raporte dhe Pasqyra Financiare <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>


Shpenzimet buxhetore gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 3,415.7 milionë euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 93.6% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar (*Buxheti 2025 në SIMFK në vlerë prej 3,648.8 milionë euro*) për këtë kategori. Përndryshe ekzekutimi të kategorisë Paga dhe shtesë duke arritur normën e ekzekutimit prej 99.6%, kategorisë Shpenzimet në subvencione dhe transfere me normën prej 98.7%, pasuar nga kategorisë Shpenzimet për mallra dhe shërbime që arrijnë në 91.6%, Shpenzimet kapitale arritën në 81.1% krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këto kategori.

Të Hyrat dhe Shpenzimet buxhetore, Buxhetin 2025 në (SIMFK) dhe Realizimin për periudhën Janar - Dhjetor 2025 në milionë euro dhe progresin e ekzekutimit në përqindje për kategori të shpenzimeve.



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Seritë Fiskale Mujore, <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

Figura në vazhdim paraqesin Shpenzimet kapitale sipas viteve 2022-2025 në milionë euro dhe rritje në % (v-m-v) .




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),

Nëse analizojm trendin e shpenzimeve kapitale për një periudhë me te gjatë kohor, 2015-2025, në raport me gjithsej shpenzimet dhe në raport me BPV-në, vrehet se kategoria te shpenzimet kapitale gjatë periudhës 2015 - 2018 kanë shënuar rritje graduale, si në raport me BPV-në, po ashtu edhe me gjithsej shpenzimet buxhetore. Në vitet 2019 - 2022 vërehet një rënie e ndjeshme e pjesëmarrjes së tyre, duke arritur nivelin më të ulët në këtë periudhë (v.2022 në 16.6% ne raport me gjithsej

shpenzimet dhe 4.7% ne raport me BPV-në). Ndërsa nga 2023 deri në 2025 shihet një rikuperim dhe rritje graduale, megjithatë këto nivele mbeten ende më të ulëta krahasuar me periudhën para vitit 2019.

Figura në vazhdim paraqet Shpenzimet kapitale në % në raport me gjithsej shpenzimet dhe BPV-në, periudha 2015-2025.




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Ndryshimet në shpenzimet kapitale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen BPV-së. Kur shpenzimet kapitale rriten, zakonisht rriten edhe investimet publike, në energji, në infrastrukturë, arsim dhe projekte zhvillimore. Këto investime përmirësojnë produktivitetin e ekonomisë, krijojnë vende pune dhe stimulojnë aktivitetin ekonomik, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e përgjithshme ekonomike. Në periudhat kur shpenzimet kapitale kanë vlera më të ulëta, në parim investimet publike zvogëlohen dhe kjo mund të ngadalësojë zhvillimin ekonomik, pasi realizohen më pak projekte infrastrukturore dhe investime afatgjata.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara

Në periudhën Janar - Dhjetor 2025 gjithsej janë regjistruar 13,123 ndërmarrje të reja, ky numër parqet një rritje prej 8.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa trendi i ndërmarrjeve të shuara arrinë shifren prej 1,350 ndërmarrjeve të shuara, një rënie prej rreth 17.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Garfiku në vazhdim paraqet ndërmarrje të reja të regjistruara dhe të shuara sipas tremujoreve gjatë viteve 2022 deri 2025.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve nga gjithsej 13,123 ndërmarrje të reja gjatë vitit 2025: Regjioni i Prishtinës prinë me 46.9%, Regjioni i Ferizajt me 11.2%, Regjioni i Prizrenit me 10.1%, Mitrovicës me 9.8% dhe Regjioni i Gjilanit me 8.2% etj. Sa i përket ndërmarrjeve të shuara nga gjithsej 1,350 ndërmarrje të shuara, përseri prinë Prishtina me 33.6% pasuar nga Mitrovica me 16.5%, Prizreni me 13.5%, dhe Gjilani me 11.4 % etj.

Garfiku në vazhdim paraqet ndërmarrje e reja të regjistruar dhe të shuara në %, sipas Regjioneve për periudhën Janar - Dhjetor 2025.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Aktivitetet ekonomike më të preferuara në regjistrimin e ndërmarrjeve të reja gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 3,122 apo 23.8% regjistrimin te ndërmarrjeve e reja, Prodhim me 1,441 apo 11.0%,

Ndërtimtari me 1,402 apo 10.7%, Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 1,364 apo 10.4%, Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 1,237 apo 9.4%, si përqindje të regjistrimi ndërmarrjeve të reja etj.

Tabela në vazhdim paraqet ndërmarrjet e reja të regjistruar në 2025 në numër dhe përqindja si sipas aktivitetit ekonomike.

Aktivitetet ekonomike	Mikro	Të Vogla	Të Mesme	Të Mëdha	Gjithsej	struktura në %
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	431	1	0	0	432	3.3%
B Xehetari dhe gurëthyes	27	2	0	0	29	0.2%
C Prodhim	1,419	21	1	0	1,441	11.0%
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	125	0	0	0	125	1.0%
E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	28	1	0	0	29	0.2%
F Ndërtimtari	1,390	11	1	0	1,402	10.7%
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	3,107	15	0	0	3,122	23.8%
H Transport dhe ruajtje	408	6	0	0	414	3.2%
I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1,211	26	0	0	1,237	9.4%
J Informacion dhe komunikim	900	4	0	0	904	6.9%
K Aktivitete financiare dhe sigurimit	125	0	0	0	125	1.0%
L Aktivitete të patundshmërisë	214	1	0	0	215	1.6%
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1,356	8	0	1	1,365	10.4%
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	825	9	0	0	834	6.4%
O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	18	0	0	0	18	0.1%
P Arsim	149	2	0	0	151	1.2%
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	331	0	0	0	331	2.5%
R Art, zbavitje dhe rekreacion	236	1	0	0	237	1.8%
S Aktivitete të shërbimeve tjera	712	0	0	0	712	5.4%
Gjithsej në nr.	13,012	108	2	1	13,123	100.0%
Gjithsej në %	99.2%	0.82%	0.02%	0.01%	100.0%	


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Ndërmarrjet e reja kryesisht janë regjistruar në kategorinë “Mikro Ndërmarrje” (1 deri në 9 të punësuar) janë 13,012 apo me rreth 99.2%, në kategorinë “Ndërmarrje të Vogla” (10 deri 49 të punësuar) janë 108 apo rreth 0.82%, në kategoritë “Ndërmarrje të Mesme” (50 deri 249 të punësuar) janë 2 apo rreth 0.02% ndërmarrje të regjistruara dhe “Ndërmarrje të Mëdha” (mbi 250 të punësuar) kemi vetëm 1 apo rreth 0.01% ndërmarrje të regjistruara në këtë periudhë.

Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve sipas aktivitetit deri dhjetor 2025

Bazuar në të dhënat e fundit nga Administrata Tatimore, numri i përgjithshëm i bizneseve numri i bizneseve gjendja me 31 dhjetor 2025, ka arritur shifrën prej 139,767 bizneseve aktiv me gjithsej qarkullimi të deklaruar prej 24,165.1 milionë euro, me gjithsej 441,951 të punësuarve, (të dhëna të përpunuara deri 24 shkurt 2026).

Garfiku në vazhdim paraqet numrin e bizneseve aktive për periudhën Janar - Dhjetor nëpër vite.



Burimi: Administrat Tatimore e Kosovë (ATK), (*) të dhënat bazohen në deklaratimet e procesuara dt.24.02.2026,



Strukturuar e bizneseve aktiv në % deri Dhjetor 2025,

Numri i përgjithshëm i bizneseve aktive ndahet në katër kategori bazuar në madhësinë sipas numrit të punëtorëve: Mikro, Të Vogla, Të Mesme dhe Të Mëdha. Bizneset Mikro dhe Të Vogla përbëjnë rreth 86.0% të totalit (120,133 biznese), ndërsa bizneset Të Mesme zënë 10.1% (14,146 biznese), dhe ato Të Mëdha përbëjnë 3.9% (5,488 biznese).

Bruto qarkullimi i deklaruar për vitin 2025 arrin në rreth 24,165.1 milionë euro. Nga ky total, bizneset Mikro dhe Të Vogla marrin pjesë me vetëm 2.1% (483.1 milionë), bizneset Të Mesme me 9.9% (2,397.3 milionë), ndërsa bizneset Të Mëdha përbëjnë pjesën më të madhe, me 88.1% (21,284.7 milionë), të qarkullimit total.

Nga ana tjetër, prej gjithsej 441,951 të punësuarve, bizneset Mikro dhe Të Vogla përfshijnë 35.8% (apo 158,208 të punësuar), bizneset Të Mesme përbëjnë rreth 17.9% (apo 79,073 të punësuar) dhe bizneset Të Mëdha zënë 46.3% (apo 204,670 të punësuar), të totalit të punësuarve.

Në tabelën në vijim paraqitet numri i bizneseve aktive deri më datë 31.12.2025, i ndarë sipas veprimtarisë ekonomike dhe madhësisë, bazuar në kriterin e numrit të punëtorëve.

Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	Mikro	Të Vogla	Të Mesme	Të Mëdha	TOTALI
0	Mungon aktiviteti	1,925	149	97	32	2,203
1	Bujqesia;Pyltaria dhe Peshkimi	3,435	646	191	46	4,318
2	Industria nxjerrëse	365	36	59	35	495
3	Industria perpunuese	8,721	3,756	2,073	875	15,425
4	Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajer te kondicionuar	531	17	24	43	615
5	Furnizimi me uje; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe te trajtimit te mbeturinave	362	73	31	48	514
6	Ndertimtaria	7,246	2,485	1,625	786	12,142
7	Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoeikletave	23,852	9,653	4,667	2,365	40,537
8	Transporti dhe magazinimi	3,275	827	567	195	4,864
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	7,977	3,337	1,123	164	12,601
10	Informimi dhe komunikimi	4,413	1,124	678	205	6,420
11	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	702	210	69	58	1,039
12	Aktivitetet e patundshmerise	1,157	177	158	48	1,540
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	6,846	3,321	1,132	185	11,484
14	Sherbimet administrative dhe mbeshtetese	3,769	1,171	449	184	5,573
15	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshem	344	42	52	22	460
16	Arsimi	989	491	170	25	1,675
17	Aktivitetet e shendetit te njeriut dhe te punes sociale	1,686	1,407	490	67	3,650
18	Artet, Argetimi dhe rekreacioni	1,735	540	118	27	2,420
19	Aktivitetet e tjera sherbyese	9,075	2,203	373	74	11,725
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhenes; Mallrat dhe sherbimet e padiferencuara, Aktivitetet e ekonomive familjare perdorim vetanak	5	-	-	-	5
21	Aktivitetet e trupave dhe organizatave nderkombetare	57	1	-	4	62
Gjithsej:		88,467	31,666	14,146	5,488	139,767

Burimi: Administrat Tatimore e Kosovë (ATK)

(*)të dhënat 31 dhjetor, bazohen në deklaratimet e procesuara dt. 24.02.2026,

Sipas të dhënave nga administrata tatimore deri me 31 dhjetor 2025, janë gjithsej 5,488 biznese Të Mëdha përkatësisht 3.9% nga numrit të përgjithshëm të bizneseve aktive, kjo kategori kanë deklaruar rreth 21,284.7 milionë euro apo 88.1% të qarkullimit të përgjithshëm dhe punësojnë rreth 204,670 të punësuar apo rreth 46.3% të të punësuarve.

Në tabelën në vijim paraqesim numri e bizneseve të Mëdha deri 31 dhjetor nëpër vite, sipas aktiviteteve.

Nr.	Përshkrimi i Aktivitetit	2022	2023	2024	2025
0	Mungon aktiviteti	30	31	31	32
1	Bujqesia, Pylltaria dhe Peshkimi	44	44	44	46
2	Industria nxjerrëse	34	34	34	35
3	Industria përpunuese	804	843	868	875
4	Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	34	38	42	43
5	Furnizimi me ujë Kanalizimi, Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	43	46	47	48
6	Ndërtimtaria	665	721	765	786
7	Tregtia me shumicë dhe pakicë Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	2,022	2,173	2,306	2,365
8	Transporti dhe magazinimi	165	173	189	195
9	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	144	156	162	164
10	Informimi dhe komunikimi	171	186	200	205
11	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	57	58	58	58
12	Aktivitetet e patundshmërisë	38	42	46	48
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	161	169	180	185
14	Shërbimet administrative dhe mbështetëse	152	164	181	184
15	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	22	22	22	22
16	Arsimi	24	25	25	25
17	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të ës sociale	62	66	67	67
18	Artet, argëtimi dhe rekreacioni	20	23	25	27
19	Aktivitetet e tjera shërbyese	71	72	74	74
20	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallrat dhe shërbimet e padiferencuara, te ekonomive familjare perdorim vetanak	-	-	-	-
21	Aktivitetet e trupave dhe organizatave ndërkombëtare	4	4	4	4
Gjithsej:		4,767	5,090	5,370	5,488

Burimi: Administrat Tatimore e Kosovë (ATK)

(*) të dhënat 31 dhjetor, bazohen në deklaratimet e procesuara dt. 24.02.2026,

Te kategoria të Mëdha struktura e bizneseve aktive në Kosovë (mesatarja 2022-2025), te ndarë sipas aktivitetit ekonomik dhe shprehur në përqindje, tregon përqendrimin e tyre në disa sektorë kryesorë. Në krye qëndron Tregtia me shumicë dhe pakicë, përfshirë riparimin e mjeteve motorike dhe motoçikletave, e cila përbën rreth 42.8% të numrit total të bizneseve aktive (të Mëdha), pasuar nga sektori i Prodhimit (industria përpunuese) me 16.4% dhe Ndërtimtaria me pjesëmarrje prej 14.2%. Një pjesë e konsiderueshme përbëhet edhe nga biznese me aktivitetet si Informimi dhe komunikimi marrin pjesë me 3.7%, Transporti dhe magazinimi me 3.5%, Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 3.4% dhe Akomodimit dhe shërbimeve me ushqim me pjesëmarrje prej 3.0% etj. si përqindje e numrit të përgjithshëm të bizneseve aktive (te katërgori të Mëdha).



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës
Email: info@oek-kcc.org
Web: www.oek-kcc.org